



## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

#### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 22 maj 2018, në mbledhjen e II-të (dytë,) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Bashkim Sylja, Shaban Ahmeti, Valmire Lahu, Radisav Perović, Mefail Rama, ndërsa mungoi, Albina Avdiu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Nexhmedin Feta, Policia Kufitare, Fadil Babatinca Policia e Kosovës, Bekim Karaxhija nga OSBE, dhe Angela Magera KFOR - LMT.

#### **Miratimi i rendit të ditës**

**z.Shaban Ahmeti**, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, i njoftoi rreth pikave të rendit të propozuar të ditës. Meqë nuk pati diskutim rreth rendit të ditës, kryesuesi e hedh në votim.

**z.Liman Zeqiri**, theksoi, tek pika 2 rendit të ditës është lëshuar një gabim të cilin mund ta quaj si teknik, përkatësisht duhet të jetë raport i punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, andaj kërkoj të korrigjohet.

*Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe korrigjimin e gabimit teknik të cekur nga parafolësi.*

#### **1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e mbajtur më 23 prill 2018**

*Njëzëri u miratua.*

## 2. Raporti i punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për vitin 2017

**z.Liman Zeqiri**, shëf i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK, e paraqiti fjalën hyrëse përkatësisht raportin e punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për vitin 2017, për të cilin tha se është përgatitur shumë më herët por për shkak të themelimit dhe konstituimit të këtij Komiteti nuk kemi mundur të paraqesim më herët. Në vazhdim foli detajisht për të gjitha fushat, sektorët, bashkëpunimet, raportet, projektet – infrastrukturën dhe ofrimin e shërbimeve publike të cilat ndërlidhen me Komunitetet jo shumicë në territorin e Komunës së Podujevës si dhe për çështje tjera të cilat përfshihen në raport.

**znj.Doruntina Hasani**, theksoi, parafolësi e tha që Komuna e Podujevës ka bërë shumë për shkollim të nxënësve të Komuniteteve dhe për një gjë të tillë shumë Komuna na e kanë lakminë, mirëpo numri ishte shumë i vogël. Mendoj se është gjendja e rëndë ekonomike, por më shumë janë në pyetje trajnimet vetëdijësuese që ata nuk kanë mund të arrijnë, si dhe Komuniteteve pakicë nuk iu jepet hapësirë as në Komunë as në vende tjera. Konsideroj se ky është problemi dhe do të doja që në planë të punës të përfshihen edhe trajnimet vetëdijësuese.

**z.Liman Zeqiri**, shëf i ZKKK, përgjigje parafolëses, nëse anëtarja parafolëse e ka lexuar këtë raport, të gjitha ato që i ceku janë të përfshira në të. Rreth shkollimit të nxënësve të Komuniteteve jo shumicë mendoj se parafolësja nuk më ka kuptuar mirë, unë i paraqita edhe problematikat në këtë aspekt, dhe asnjëherë nuk kam qenë i kënaqur në tërësi me shkollimin e nxënësve të Komuniteteve duke përfshirë edhe numrin që ishte 166 për vitin 2017. Në fakt unë e thash se ka ngritje të vazhdueshme të cilësisë së arsimimit, dhe këtë e bazoj në atë që këtë Komitet e përcjellë nga viti 2003, andaj e thash që shumë Komuna na e kanë lakminë në disa aspekte – kritere dhe atë duke falënderuar Drejtorinë e Arsimit, sa për sqarim, nxënësit të cilët e përfundojnë klasën e IX-të duhet t'i nënshtrohen një testi, e që nuk mund ta arrijnë rezultatin dhe shumë prej tyre mbesin jashtë bankave shkollore, në kuadër të kësaj ka ndodh që nuk arrihen poenat e mjaftueshëm dhe vijnë në ZKKK ku pastaj ne si Zyrë ka pas raste që kemi intervenuar që ata nxënës të mos mbesin jashtë procesit mësimorë edhe pse nuk kanë arritë kuotën, pra qëllimi ka qenë që ata që kanë dëshirë të vijnë në procesin mësimorë, t'i mundësohet një gjë e tillë, si Komunë jua kemi mundësuar këtë dhe kjo ishte në kontekst ajo çfarë e thash në fjalën hyrëse.

**znj.Doruntina Hasani**, theksoi, kur e ceka paraprakisht se duhet të ketë trajnime vetëdijësuese për pjesëtarët e Komuniteteve jo shumicë e bazova edhe në atë që më kujtohet se kur kemi qenë më të rinj – në shkollë fillore shumë nxënës të këtyre Komuniteteve e kanë ndërprerë shkollimin, dhe duke marrë për bazë atë, mendoj që është nevojshme të ketë trajnime të tilla për fëmijët – nxënësit e Komuniteteve jo shumicë.

**z.Liman Zeqiri**, shëf i ZKKK, sa i përket trajnimeve vetëdijësuese që u ceken, unë ju them se janë në kuadër të planit të veprimit 2016 – 2020 dhe që disa prej tyre janë realizuar, dokument të cilin do t'ju a sjell edhe juve nëse veç nuk e keni. Pastaj, përveç gjendjes së rëndë ekonomike, problematikë tjetër janë edhe martesat e hershme, gjë e cila është realitet. Është shumë normale që të ketë trajnime të tilla, komunikime të ndryshme me kryefamiljarët, pastaj me këshillin e prindërve e të ngjashme, mandej duhet të ketë rol më të madhe edhe Drejtoria e Arsimit në këtë aspekt, do të thotë duhet të ketë një opinion më të gjerë, por si bazë nganjëherë është gjendja ekonomike e cila në shumë raste imponon edhe martesat e hershme e që pastaj ndikon edhe në vazhdimin ose jo të shkollimit të mesëm. Pastaj kemi edhe ndihmat sociale që jepen e që ka raste ku familjet bëjnë fëmijë që në një formë është parakusht për të marrë atë ndihmë.

**z.Bashkim Syl**a, theksoi, e kam lexuar këtë raport dhe jam shumë i kënaqur me angazhimin e bërë nga ZKKK për Komunitetet jo shumicë. Mirëpo u fol për demokraci, mirëqenie sociale e të tjera, por unë mendoj se këto nuk mund të bëhen pa u shkolluar fëmijët e Komuniteteve sepse as nuk mund të punësohen e që pastaj mund të ndikoj në shkollim të fëmijëve të tyre dhe probleme tjera të cilat ndërlidhen njëra pas tjetrës. Mendoj se Kryesuesi i këtij Komiteti dhe Komuna e Podujevës e kanë përgjegjësinë më të madhe sa i përket ndihmës në shkollimin e fëmijëve të Komuniteteve jo shumicë, sidomos shkollimin e mesëm sepse pastaj vetëdijesimi rritet vetvetiu, gjë e cila mendoj se është dashur të ketë plane nga viti 2003 – 2004 në mënyrë që tash do të kishte një gjeneratë të të arsimuarve dhe që natyrisht tani do të kishte formësim më të mirë, mirëqenie më të mirë.

**z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komitetit**, theksoi, asnjë Komunë në Kosovë përveç Komunës së Podujevës nuk i jep tekstet shkollore falas për nxënës të shkollave të mesme, në këtë rast fjala është për nxënësit e Komuniteteve jo shumicë dhe kjo ndodh disa vite me radhë dhe për këtë disa herë e kam falënderuar dhe vazhdoj ta falënderoj Komunën e Podujevës përkatësisht Kryetarin e Komunës për një ndihmë të tillë. Po ashtu ka shumë familje të Komuniteteve që vazhdimisht janë ndihmuar nga Komuna qoftë me subvencione, strehim, banim dhe ndihma tjera të nevojshme.

**znj.Dornuntina Hasani**, konsideroj se u keqkuptuam sepse ne po pajtohemi me atë që ju po e thoni, por si ide apo kërkesë ishte që trajnimet vetëdijesuese janë të mirëseardhura për Komunitetet në mënyrë që ata të kenë sa më shumë dijeni rreth organizimit dhe çështjeve tjera jetësore, qoftë për martesë të hershme që u përmenden dhe gjëra tjera.

**z.Liman Zeqiri**, shëf i ZKKK, është e qartë ajo që u tha nga parafolësja në diskutimet e saj, dhe pajtohemi për këtë, mirëpo rreth kësaj çështjeje ne mund të bëjmë debat me orë të tëra.

Për çështje të tilla sa i përket komuniteteve ndoshta kam mund të doktoroj sepse jam marrë vazhdimisht me këtë problematik. Unë në fillim e thash që themeli ose baza për Komunitetet është arsimi, pastaj problem tjetër është që të gjithë atyre që janë në shkollim të mesëm, me të gjitha mundësit, aktivitetet dhe çështjet tjera unë jua rregulloj dokumentacionin dhe të gjithë marrin bursa nga OJQ “Vois of Roma”. Drejtorja e Arsimit në bashkëpunim me OJQ-të “Qëndrimi” dhe “Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve” përmes organizimit të mësimin intensiv plotësues për nxënësit e shkollave fillore nga klasa e parë deri në të nëntën, ku funksionojnë dy klasë, njëra ka 41 nxënës dhe funksionon në shkollën “Dr Ibrahim Rugova”, dhe njëra në Lagjen “Ali Ajeti” e cila ka 44 nxënës, klasë këto të cilat vijojnë mësimin në dy ndërrime, program ky i cili mbështetet edhe nga Drejtorja e Arsimit dhe normal financohet nga OJQ “Voice of Roma” e që në bashkëpunim dhe në koordinim me OJQ-në “Qëndrimi” janë formuar paralelet e cekura ku janë 4 mësimdhënës.

Pra Shoqata të ndryshme dhe OJQ-të ndërkombëtare e kanë bërë të vetën me ato mundësi që i kanë, por krejt problematika është te shkollimi i mesëm sepse studimet janë më problem në vetë, andaj duke pasë parasysh se shkollimi është bazë – themel i një vendi, shkollimi sa më i lartë i nxënësve të Komuniteteve do të ishte i mirëseardhur edhe për vetë vendin. Pra nëse nga 166 nxënës, po të vijonin shkollimin e mesëm 150 dhe nga ta 50 të regjistroheshin në studime atëherë do të mund të diskutonim për një nivel të kënaqshëm të shkollimit të Komuniteteve, pavarësisht kësaj jemi të vetëdijshëm se paraluftës kanë qenë shumë një numër i vogël i atyre që janë shkolluar, dhe duke marrë parasysh këtë mund të themi se gradualisht jemi në rrugë të mirë të vetëdijesimit sa i përket arritjeve në shkollim. Andaj pa dashur të lëshohem në analiza, krejt problemi mendoj se është tek baza ekonomike.

Gjithashtu dëshiroj t'ju njoftoj edhe me një element shumë të rëndësishëm, fjala është se të gjithë ata nxënës por edhe student të Komuniteteve jo shumicë të cilët kanë aplikuar për bursë në Drejtorinë e Arsimit, të gjithë kanë qenë përfitues.

**z.Nexhmedin Feta**, nga Stacioni Policorë për mbikëqyrje të kufirit – Kërprimeh, theksoi, dua të ndërlihem rreth asaj që anëtarja e këtij komiteti parafolëse e ceku sa i përket vijimit në shkollë, dukuri kjo e cila nuk është e shfaqur vetëm tek Komunitetet RAE por është edhe në nivel vendi, sepse kemi raste kur babai merr djalë 12-13 vjeçar, në mal për të prerë dru për një shumë ndoshta prej 10-20 euro, kurse e ndal prej shkollës e që pastaj praktikohet disa herë kjo deri sa ndalet krejt prej shkolle, gjë kjo e cila është evidente sidomos në zonat rurale ku kemi banorë të cilët merren vetëm me bujqësi dhe blegtori, dhe kot iu thuhet atyre shkollohuni.

**z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komitetit**, theksoi, diskutime të tilla janë të mirëseardhura, por sa i përket kësaj pike kemi të bëjmë me raport, e jo debat rreth çështje së caktuar, të gjithëve ju është dërguar raporti dhe keni mund ta analizoni në detaje, andaj ta përfundojmë këtë pikë.

**z.Mefail Rama**, theksoi, përshëndes raportin e ZKKK –së i sjellë nga shefi i kësaj Zyreje, raport i cili tregon aktivitetet dhe punët e kryera në përgjithësi gjatë vitit 2017. Sa kam informata, Komunitetet janë të kënaqura me punën e bërë, mirëpo nuk do të thotë se nuk dëshirojmë sa më shumë të punohet për Komunitetet dhe për vendin në përgjithësi, në mënyrë që të arrijmë më shumë si shoqëri. Sa i përket çështjes së riatdhesimit ku në raport flitet për kompetenca dhe çështje tjera të ngjashme, dëshira jonë është që në të ardhmen të punohet më shumë në këtë drejtim, me theks të veçantë rreth vetëdijesimit, informimit dhe gjërave të ngjashme sa i përket riatdhesimit në përgjithësi, dhe atë jo vetëm për komunitetet RAE, andaj e përsërisë kërkesën për ZKKK-në që të punoj më shumë me departamente të ndryshme të cilat janë të kyçura në programin e riatdhesimit. Sa i përket shkollimit, ne në përgjithësi jemi të kënaqur me shkollimin e nxënësve të Komunitetit RAE ku aktualisht kemi rreth 170 nxënës në shkolla dhe nivele të ndryshme në Komunën e Podujevës, mirëpo sa do të arrijnë suksese dhe sa do ta vijnë shkollimin e mëtutjeshëm mbetet të shihet. Tani për vitin e ri shkollor kemi rreth 20 nxënës të cilët do të regjistrohen në shkollë dhe në këtë aspekt falënderojmë Komunën e Podujevës për mundësinë e dhënë që nxënësit të regjistrohen pa kuotë. Ne si Komitet kemi punuar shumë për arsimim të fëmijëve të Komunitetit RAE, por ende nuk jemi të kënaqur krejt dhe kërkesa jonë është që kjo gjendje të përmirësohet në vazhdimësi.

Falënderoj z.Liman Zeqirin për paraqitjen dhe sqarimet e dhëna për raportin në fjalë.

**z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komitetit**, theksoi, konsideroj se debati rreth këtij raporti përfundoj, secili prej nesh pati mundësi të paraqesë mendimet, sugjerimet dhe idetë e veta, andaj meqë ky është raport dhe konsideroj se nuk ka nevojë të hedhet në votim, kalojmë pikën e radhës.

### **3. Propozim Plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018**

**z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komisionit**, theksoi, në mbledhjen e kaluar është formuar një grup punues për përgatitjen e planit të punës, Grupi është takuar dhe kemi përgatitë këtë plan të punës për vitin 2018, edhe pse pa kurrfarë arsye dhe paralajmërimi nuk ka marrë pjesë anëtarja nga radhët e LVV-së e cila konsideroj se është dashur të lajmëroj paraprakisht për mungesën, situatë të cilën e kemi edhe sot me mungesën e anëtares znj.Albina Avdiu.

**z.Bashkim Syl**a, theksoi, ne si Grup e kemi përgatit vetë këtë plan të punës dhe konsideroj se nuk kemi nevojë të ndalemi shumë me diskutime rreth këtij Plani sepse ky është dërguar me kohë dhe kemi pasë mundësi të gjithë ta analizojmë këtë.

*Nga diskutimet u propozua që me rastin e vizitës në shkollat e fshatrave Batllavë dhe Orllan të vizitohet edhe z.Radisav Perović në Fshatin Metergoc*

**z.Radisav Perović**, theksoi, dëshiroj të paraqes rastin tim, isha disa ditë në Medvegj dhe posa jam kthyer në Metergoc kam parë se më është prerë pylli, dhe kjo më ka shqetësuar bukur shumë. Kërkoj nga organet e rendit që të ndërmarrin masa lidhur me rastin e cekur.

Sa i përket vizitës së këtij Komuniteti në fshatin Metergoc, për momentin nuk mund t'ju them asgjë por mbetet të shihet ditëve në vijim ku mund të bisedojmë sërish, andaj për këtë mbetemi në kontakt.

**z.Shaban Ahmeti, Kryesues i Komisionit**, theksoi, e hedh në votim këtë propozim plan të punës duke marrë për bazë edhe propozimet e dhëna.

*Njëzëri u miratua ky propozim Plan i punës duke përfshirë edhe propozimet e dhëna në këtë mbledhje.*

#### **4. Të ndryshme**

Nuk pati diskutime

*Kryesuesi përfundoi mbledhjen pasi që nuk pat çështje tjera për shqyrtim.*

**Mbledhja përfundoi në orën 12.05'**

**Procesverbalin e mbajti**  
**Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/04-0041574/18**  
**Podujevë,**  
**22 maj 2018**

**Kryesues i Komiteti**  
**Shaban Ahmeti**